

KONTRATË BINJAKËZIMI

Përkrahje për Statistikat

Kosovë



RAPORT MBI MISIIONIN

2.3.1 Përkrahje në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë
Kombëtare, me fokus në konvertimin në NACE 2

Komponenti nr 2 Llogaritë Kombëtare

Misioni i udhëhequr nga
Clementina Ivan-Ungureanu,
Statistikat e Danimarkës

25-29 Gusht 2014

IPA 2012

Clementina Ivan-Ungureanu

Statistics Denmark

Sejrøgade 11

DK-2100 Copenhagen Ø

Denmark

Tel: +

Email: clementina@ivan-ungureanu.ro

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
1. Komentet e përgjithshme	5
2. Vlerësimet dhe rezultatet.....	6
3. Konkluzionet dhe Rekomandimet	7
Aneksi 1. Termat e Referencës	8
Aneksi 2. Personat e takuar	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.

Lista e Shkurtesave

ANA	Llogaritë Vjetore Kombëtare
BoPs	Bilanci i Pagesave
BEC	Kategorite e medha ekonomike
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
KKF	Konsumi i Kapitalit Fiks
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
ESA 95	Sistemi Evropian i Llogarive 95
ESA 2010	Sistemi Evropian i Llogarive 2010
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
FBKF	Formimi Bruto i Kapitalit Fiks
KFQ	Konsumi Final i Qeverisë
SHKFEF	Shpenzimet e Konsumit Final të Ekonomive Familjare
IC	Konsumi i Ndërmjetëm
IÇIM	Indeksi i Çmimeve të Importit
IPA	Instrumenti Para Asociim-Stabilizimit
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
TI	Teknologjia Informatike
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
LLKT	Llogaritë Kombëtare Tremujore
BPVT	BPV Tremujor
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
MOU	Memorandum i Mirëkuptimit
LLK	Llogaritë Kombëtare
NACE rev.1	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike, rev. 1
NACE rev.2	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike, rev. 2
DLLK	Departamenti i Llogarive Kombëtare

NOE	Ekonomia e pavrojtuar
OJQ	Organizatat Jo Qeveritare
IÇP	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
R&D	Kërkimi dhe Zhvillimi
SIDA	Agjencioni Ndërkombëtar Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim
ASN	Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve
STS	Statistikat Afat-Shkurta
SUT	Tabelat Ofruse-Përdoruese
TeR	Termet e Referencës

Përmbledhje ekzekutive

Misioni aktual, i realizuar në periudhën 25-29 Gusht të vitit 2014, nën komponentin e 2-të – Llogaritë Kombëtare të Projektit të Binjakëzimit, kishte si objektiv kryesor të ofrojë përkrahje për ASK-në në implementimin e NACE rev.2 në llogaritë kombëtare për periudhën 2008-2012.

Në fillim të këtij viti, ka filluar rishikimi i BPV-së vjetore sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve në kuadër të projektit të FMN-së, për periudhën 2008-2012. Rishikimi ishte i fokusuar në vlerësimet: (i) outputi dhe konsumi i ndërmjetëm i njësive jo-financiare; (ii) outputi i qeverisë (përfshirë edhe metodën e re për kalkulimin e SHKF-së); (iii) Shpenzimet e Konsumit Final të Ekonomive Familjare (SHKFEF); (iv) qeraja e perlllogaritur dhe (v) Formimi Bruto i Kapitalit Fiks (FBKF).

Të dhënat e rishikuar për periudhën 2008-2012 ishin në dispozicion në fillim të misionit. Të dhënat nuk janë të finalizuara, BPV sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve në çmimet aktuale dhe konstante nxjerr në pah disa mosperputhje. Gjatë misionit, para fillimit të aktivitetit për kalimin në NACE rev.2, janë bërë analiza të BPV-së sipas qasjes së prodhimit dhe janë ofruar rekomandimet për përmirësimet.

Duhet të theksohet që NACE rev.2 ende nuk është implementuar në sistemin e statistikave të Kosovës. Autoritetet e Administratës Tatimore kanë filluar të përkthejnë bizneset e regjistruara në NACE rev.2, por ky proces nuk ka përfunduar. Në këto kushte, përkthimi në NACE rev.2 në kornizën e llogarive kombëtare ka karakter eksperimental dhe vlerësimet do të përmirësohen që të jenë në korrelacion me indikatorët e tjerë statistikorë. Për kalimin në NACE rev.2, është përdorur tabela korresponduese e krijuar nga Departamenti i Statistikave të Biznesit dhe vlerësimet preliminare të BPV sipas prodhimit janë realizuar për periudhën 2008-2012. Tabela e njëjtë korresponduese është përdorur edhe për çmimet konstante, për shkak se IÇP bazuar në NACE rev.2 nuk ka qenë ende e gatshme. Rezultatet e para do të rishikohen dhe përmirësohen bazuar në burimet e të reja të të dhënave, që janë në dispozicion.

1. Komentet e përgjithshme

Ky raport i misionit është përgatitur në kuadër të projektit të Binjakëzimit ‘Përkrahje për Statistikat’.

Objekti konkret i misionit ka qenë konvertimi i vlerësimeve të mëparshme të BPV në NACE rev.2 për periudhën 2008-2012.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përpunuar me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës dhe partnerëve të tjerë (NI-CO/Statistikat e Finlandës/Istat/Statistikat e Lituanisë).

2. Vlerësimet dhe rezultatet

Jane rishikuar seritë kohore të BPV sipas qasjes së prodhimit për periudhën 2008-2012 dhe vlerësimet e para ishin në dispozicion në fillim të misionit.

Vlerësimet e BPV sipas qasjes së prodhimit kane filluar në kuader të kornizës IPA 2010, në periudhën Prill 2011-Shtator 2012; BPV në çmimet aktuale dhe konstante është elaboruar për periudhën 2008-2011. Për kalkulimin e BPV-së për vitin 2012, ASK ka pasur përkrahje teknike nga ana e FMN-së. Vitin e kaluar, FMN ka propozuar një metodë të re të vlerësimit të outputit (O) dhe konsumit të ndërmjetëm (IC) bazuar në të dhënat e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve (ASN) dhe ka përkrahur ASK-në në realizimin e rishikimit të të dhënave 2008-2012. Vlerësimet e mëparshme janë bazuar në tabelat ofruese përdoruese, të elaboruar për vitet 2005, 2006 dhe 2007. Analizimi i të dhënave të reja të BPV-së sipas qasjes së prodhimit ka evidentuar mungese konsistence në seritë kohore. Pasi nuk ishte e mundur të ndërrohen vlerësimet e rishikuara, tranzicioni në NACE rev.2 është realizuar në baze të shifrave në dispozicion, që ende nuk janë publikuar. Diseminimi i tyre do të bëhet në Nëntor të vitit 2014.

ASK ka filluar procesin e implementimit të NACE rev. 2 dy vjet më parë. Klasifikimi është analizuar dhe përkthyer në gjuhën Shqipe. Grupi punues është themeluar nga ekspertët e ASK-së, Administratës Tatimore (ATK) dhe Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës ARBK (që është në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë), në mënyrë që të sigurojë kushtet për implementimin e klasifikimit të ri. Në vitin 2013, është realizuar një anketë speciale për 27000 njësi në mënyrë që të krijohet një tabelë korresponduese në mes të klasifikimit aktual (NACE rev.1) dhe klasifikimit të ri.

Bazuar në kushtet e vendit dhe rezultatet e anketës, tabela e tranzicionit është realizuar nga Departamenti i Statistikave Ekonomike.

Së bashku me ekspertët e Departamentit të Llogarive Kombëtare, të dhënat nga Statistikat Strukturore të Bizneseve (SBS) për vitin 2012 janë vlerësuar sipas NACE rev. 2 dhe janë vendosur koeficientet e tranzicionit. Koeficientet e njëjtë janë përdorur për të bërë vlerësimet e periudhës 2008-2012 në përgjithësi, të BPV sipas qasjes së prodhimit bazuar në NACE rev.2 në çmimet aktuale.

Aktualisht, ASK është në proces të rikalkulimit të IÇP-së bazuar në NACE rev.2. Të dhënat e rishikuara do të jenë në dispozicion deri në fund të vitit. Për shkak të kësaj situate, vlerësimet e para të BPV-së sipas aktivitetit bazuar në NACE rev.2 në çmimet konstante janë realizuar bazuar në të njëjtën tabelë të tranzicionit si për çmimet aktuale.

Këto aspekte janë diskutuar me stafin e DLLK-së dhe është rekomanduar të rishikohen kalkulimet kur të jenë në dispozicion të dhënat e reja. Rezultatet e para të ASN-së 2013 duhet të jenë në dispozicion në Nëntor. Këto do të përdoren për të kontrolluar cilësinë e koeficienteve dhe për të përmirësuar vlerësimet e BPV-së bazuar në NACE rev.2.

3. Konkluzionet dhe rekomandimet

Gjatë misionit, janë ofruar rekomandime të detajuara për përmirësimin e vlerësimeve të BPV-së vjetore sipas qasjes së prodhimit, si dhe konsultime në lidhje me këtë fushë.

Tranzicioni i BPV-së sipas prodhimit në NACE rev.2 do të përmirësohet në të ardhmen dhe është rekomanduar që të jetë pjesë e gjithë procesit të udhëhequr nga ASK-ja në këtë fushë. Duhet të vendoset një bashkepunim i mirë në mes të DLLK dhe Departamentit Ekonomik, veçanërisht në regjistrin statistikor të bizneseve, çmimet, statistikën dhe statistikën e biznesit.

Annex 1. Terms of Reference**Projekti i Binjakëzimit i BE-së****KS12 IB ST 01****Përkrahje për Statistikat****Termat e Referencës:****Komponenti 2: Llogaritë Kombëtare**

Aktiviteti 2.3.1: Përkrahja fillestare në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare, me fokus në konvertimin në NACE 2

Afatet:**Ter – data e finalizimit: 10 Korrik 2014****Fillimi / fund i aktivitetit: 25 – 29 Gusht 2014****Koha e raportimit: 12 Shtator 2014****Rezultatet obligative të komponentit:**

Rezultatet obligative	Intervenimi logjik	Standardet	Burimet e informacionit	Supozimet
2.3.1	Përkrahja fillestare për implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare	- Raporti i Misionit, ku përshkruhet puna e realizuar dhe ajo që duhet të ndermerret para aktivitetit të radhës, i vendosur në web faqen e projektit - Fushat e caktuara të Llogarive Kombëtare të azhuruara sipas ESA 2012	- Raportet tremujore të Projektit të Binjakëzimit - Raportet e Misioneve - Harta rrugore	- Kapacitet i mjaftueshëm - absorbimi - Numër i vogël i stafit i involvuar në implementim - Stafi punon në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, në mes të misioneve - Qasje në statistika primare të qarta - Termat e referencës, të përpiluara me

				kohe, qe paraqesin ne detaje detyrat, aktivitetet, rezultat e pritura, pjesëmarrësit ne aktivitet dhe agjendën
--	--	--	--	--

Subjekti / qëllimi i aktivitetit: 2.3.1

Konsultimet dhe diskutimet me Departamentin e Llogarive Kombëtare.

Harta rrugore për Llogaritë Kombëtare që paraqitet në tabelën nr.2 në raportin e misionit nga aktiviteti 2.1.1 (Vlerësimi dhe azhurnimi i Planit të Veprimit) nga Graversen dhe Ungureanu, kërkohet të ndërmerren disa hapa që paraqiten në detaje: Pjesë e transmetimit në ESA 2010 është të konvertohen vlerësimet e mëparshme të LLK-së në NACE rev.2. Procesi i konvertimit në vetvete është bërë vetëm nga ana e prodhimit dhe nuk duhet të ndikojë në Vlerën e Shtuar Bruto (ang. GVA) dhe BPV e përgjithshme. Kjo mund të përdoret si kontroll në kalkulime. Rekomandohet që ky transformim të kryhet si proces i ndarë, i pavarur nga ndryshimet e tjera, të sigurohet që BPV e përgjithshme të mund të kontrollohet para se të kalohet më tej në proceset e peripilimit. Ky projekt mbështetet kryesisht në urën e konvertimit në mes NACE rev.1 dhe rev.2. Çelësi i konvertimit duhet të prodhohet nga kodimi i dyfishtë dhe informatat e rishikuara mbi industrinë, në Anketën Strukturore të Ndërmarrjeve (ASN) për periudhën 2008-2012. Në mënyrë që të realizohet konvertimi i BPV-së sipas prodhimit në NACE rev.2 para transmetimit të të dhënave në Eurostat (Shtator 2014), është e nevojshme që çelësat e konvertimit, nga Departamenti Ekonomik i ASK-së, të jenë në dispozicion në Qershor.

Rezultatet e pritura nga aktiviteti 2.3.1

Raporti i misionit.

Konvertimi i vlerësimeve të mëparshme të LLK në NACE rev.2

Trajnimi gjatë orarit të punës

Stafi në ASK:

Xhevrie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare, Xhevrie.Fetahu@rks-gov.net

Ylli Shala, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ylli.Shala@rks-gov.net

Ilir Mazrekaj, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ilir.Mazrekaj@rks-gov.net

Emine Bajrami, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Emine.Bajrami@rks-gov.net

Florije Krapa, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Florije.Krapa@rks-gov.net,

Nysret Sylejmani, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Nysret.Sylejmani@rks-gov.net

Besim Mehmeti, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Besim.Mehmeti@rks-gov.net

Ilir.T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit i ASK-së:

Udhëheqës i Projektit në ASK, Z. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Homologu i RTA, Znj. Teuta Zyberi, Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie me Jashtë, teuta.zyberi@rks-gov.net

Ekspertët e vendeve anëtare:

Znj. Clementina Ivan-Ungureanu, Eksperte, Statistikat e Danimarkës, iu_clem@yahoo.com

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Znj. Nora Zogaj, RTA asistente, nzogaj@yahoo.com

Përshkrimi i historikut për aktivitetin

Raporti i Vlerësimit të Adaptuar Global i vitit 2012 (AGA) i përgatitur nga Eurostat-i deklaron në lidhje me Llogaritë Kombëtare (f. 53-54): Në vitin 2010, ASK me mbështetjen e IPA përgatiti një 'Plan të veprimit për përpilimin dhe publikimin e statistikave gjithëpërfshirëse për llogaritë kombëtare dhe tregun e punës'. Ky plan është në parim një instrument i dobishëm për organizimin dhe zhvillimin e ardhshëm të Llogarive Kombëtare së bashku me zhvillimin e standardeve dhe burimeve, që janë të nevojshme për rritjen e mbulueshmërisë dhe përmirësimin e të dhënave të llogarive kombëtare.

AGA më tej deklaron që parimisht përmirësimet dhe rritja e mbulueshmërisë së Llogarive Kombëtare vjetore duhet të jetë prioritet për ASK-në. Kalkulimi i BPV duke përdorur qasjen sipas prodhimit dhe shpenzimeve është me rëndësi të veçantë.

Aktivitetet e pritura janë:

- Konvertimi i vlerësimeve të mëparshme të BPV në NACE rev.2 për periudhën 2008-2012

Rezultatet e pritura:

- Raporti i misionit – sipas modelit për raportim
- Rekomandimet për aktivitetet e ardhshme

Aneksi 1. Programi, - Gusht 2014

Dita	Vendi	Koha	Ngjarja
1	ASK	09.00	Planifikimi i javës
		09:30-12.00	Analizimi i burimeve të të dhënave dhe konvertimi i tabelave nga NACE rev.1 në NACE rev.2 Konsultimi dhe trajnimi gjatë orarit të punës
		12.00-13.00	Dreka
		13.00-17.00	Analizimi i burimeve të të dhënave dhe konvertimi i tabelave nga NACE rev.1 në NACE rev.2 – vazhdim
2	ASK	09:00-12.00	Vlerësimi i BPV për periudhën 2008-2012 bazuar në NACE rev.2. Konsultim dhe trajnim gjatë orarit të punës
		12.00-13.00	Dreka
		13.00-17.00	Vlerësimi i BPV për periudhën 2008-2012 bazuar në NACE rev.2 - vazhdim Konsultim dhe trajnim gjatë orarit të punës
3	ASK	09:00-12.00	Vlerësimi i BPV për periudhën 2008-2012 bazuar në NACE rev.2 - vazhdimi Konsultim dhe trajnim gjatë orarit të punës
		12.00-13.00	Dreka
		13.00-17.00	Vlerësimi i BPV për periudhën 2008-2012 bazuar në NACE rev.2 - vazhdimi Konsultim dhe trajnim gjatë orarit të punës
4	ASK	09:00-12.00	Vlerësimi i BPV për periudhën 2008-2012 bazuar në NACE rev.2 - vazhdimi Konsultim dhe trajnim gjatë orarit të punës
		12.00-13.00	Dreka
		13.00-17.00	Vlerësimi i BPV për periudhën 2008-2012 bazuar në NACE rev.2 - vazhdimi Konsultim dhe trajnim gjatë orarit të punës
5	ASK	09:00-12.00	Rishikimi i punës së përfunduar dhe problemet kryesore
		12.00-13.00	Dreka
		13.00-17.00	Takim mes ekspertëve, udhëheqësit të projektit, te komponentit dhe RTA

Aneksi 2. Personat e takuar

ASK:

Llogaritë Kombëtare

Ilir Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombetare

Xhevrie Fetahu, shef i Departamentit të Llogarive Kombëtare, Ylli Shala, Ilir Mazrekaj, Emine Bajrami Florije Krap, Nysret Sylejmani, Besim Mehmeti, Have Kryeziu, Besim Mehmeti

Ekipi i RTA :

Per Knudsen, RTA

Nora Zogaj, RTA Asistente